



E premte, 12 qershor 2009
ref 006/09

EUSR-ja Pieter Feith: Objektivat dhe prioritetet për avancimin e perspektivës evropiane janë të përcaktuara në kuadër të kornizës së Procesit të Stabilizim Asociimit

Sot, në hapje të takimit të 16-të plenar të Mekanizmit Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asociimit (MPPSA), të kryesuar nga Komisioni Evropian dhe autoritetet e Kosovës në Prishtinë, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (EUSR) Pieter Feith ka bërë këto deklaratat:

Përfaqësuesi Special i BE-së Pieter Feith:

“Bashkëpunimi rajonal është parakusht për t’ju bashkuar BE-së. Është shumë më i rëndësishëm se një kriter, BE-ja është bashkëpunim rajonal, dhe si e tillë kërkon angazhimin e plotë të të gjithë anëtarëve të saj të tanishëm dhe të ardhshëm. Andaj, i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës të rishqyrtojë qëndrimin e saj të tanishëm. Mund t’ju siguroj se nga një qasje më përafruese jo vetëm që do të përfitonte perspektiva evropiane e Kosovës, por po ashtu kjo do të kthehej me fleksibilitet nga të gjithë akterët kryesorë të BE-së.”

“Objektivat, prioritetet dhe obligimet e Kosovës janë të përcaktuara qartë në kornizën e MPPSA-së. Dhe, tani ekziston mundësia e avancimit të perspektivës evropiane të Kosovës me një performancë të vendosur nga Qeveria e Kosovës në kuadër të kësaj kornize. BE-ja mbetet partneri juaj i përshkushuar në këtë punë, e gatshme të ofrojë mbështetjen e saj politike, teknike, financiare dhe për ngritje të kapaciteteve.”

(fund)

Shërnime për redaktorët:

Për informata të mëtejme lidhur me takimin e 16 plenar të Mekanizmit Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asociimit, luteni të vizitoni faqen e internetit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë : <http://www.delprn.ec.europa.eu/>